



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 362/4 prot.

Tiranë, më 07.07.2026

V E N D I M

Nr. 29, datë 07.07.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E VERIFIKIMIT TË LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE
ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS SË
KONKURRIMIT ME KOD #7481, TË SHPALLUR NGA DAP**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit me kod #7481, për pozicionin, “Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve”, në institucionin Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me shkresën nr. 362 prot., datë 23.02.2026, ka administruar një informacion të dërguar nga një burim anonim, në të cilin kërkohet verifikimi i ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga njësia përgjegjëse, gjatë fazës së verifikimit paraprak të kandidatëve, të cilët plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele, në procedurën e konkurrimit me kod #7481, të shpallur nga DAP.

Në përmbajtje të informacionit të administruar, ngrihen pretendime se kandidati i kualifikuar në fazën e lëvizjes paralele Sokol Kananaj, në procedurën e konkurrimit me kod #7481, “Shpallje për lëvizje paralele, ngritje në detyrë, në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”, për plotësimin e pozicionit “Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, klasa e pagës III-1”, të

shpallur nga DAP, rezulton të jetë nën hetim penal, për veprën penale “*Shpërdorim detyrë*”, vepër e regjistruar pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Në këto kushte, është kërkuar ndërhyrja e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga njësia përgjegjëse gjatë zhvillimit të kësaj procedure konkurrimi.

Me qëllim verifikimin e informacionit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenit 14, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka nisur procesin e verifikimit të informacionit, dhe nëpërmjet shkresës nr. 362/1 prot., datë 02.03.2026, me objekt: “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të administruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 362 prot., datë 23.02.2026*”, ka vënë në dijeni institucionin e Departamentit të Administratës Publike për fillimin e verifikimit të procedurës së konkurrimit, duke kërkuar dokumentacionin në të cilin është materializuar procedura e konkurrimit.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet shkresës nr.1288/1 prot., datë 09.03.2026, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 362/2 prot., datë 11.03.2026, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar, nga përmbajtja e së cilit rezulton se:

Në zbatim të VKM-së nr. 39, datë 21.01.2026, “*Për planin vjetor të pranimit, për vitin 2026, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil*”, Departamenti i Administratës Publike (DAP) ka publikuar shpalljen me kod **#7481**, për procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë në kategorinë e mesme dhe e ulët drejtuese, për plotësimin e pozicionit “*Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë*”.

Referuar përmbajtjes së shpalljes së publikuar për pozicionin vakant, rezulton se, në mbështetje të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe pikës 8, të VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar, kushtet minimale, që duhet të plotësojnë kandidatët për procedurën e lëvizjes paralele janë:

- a) të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda kategorisë III;
- b) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c) të kenë vlerësimin e fundit të performancës të paktën “*mirë*” ose “*shumë mirë*”.

Kurse kërkesat e posaçme të parashikuara në shpallje janë:

- a) të zotërojnë diplomë të nivelit “*Master Shkencor*” ose “*Master Profesional*”, të përfutuar në përfundim të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me

kohëzgjatje normale prej 2 (dy) vitesh akademike, në fushën e “*Shkencave Ekonomike*” ose “*Shkencave Juridike*”, ndërkohë që edhe diploma e nivelit “*Bachelor*” duhet të jetë në të njëjtën fushë studimi;

b) të kenë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në profesion.

Në mbështetje të këtyre kërkesave, njësia përgjegjëse DAP, në bazë të dokumentacionit të paraqitur ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet dhe kërkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Sipas dokumentacionit të administruar për këtë procedurë konkurrimi, aktit “*Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për lëvizje paralele*”, rezulton se në fazën e verifikimit paraprak është kualifikuar kandidati Sokol Kananaj, ndërsa sipas aktit “*Njoftim mbi rezultatet e verifikimit për lëvizje paralele*”, rezulton se, pas përfundimit të fazës së ankimit janë kualifikuar dhe dy kandidatë të tjerë për të vazhduar fazën e dytë të konkurimit, konkretisht: D. Çaçi dhe D. Demiri. Në përmbajtje të këtyre akteve është përcaktuar edhe data dhe vendi ku do të zhvillohet intervista e strukturuar me gojë.

Sa i takon plotësimin të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në shpalljen e pozicionit vakant, nga ana e kandidatit të kualifikuar S. Kananaj, në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati, të depozituar në dosjen e konkurimit, konstatohet se:

- në lidhje me statusin e nëpunësit civil: nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar nga Komisioneri gjatë shqyrtimit të rastit, rezulton se, me aktin nr. 7063/1 prot., datë 04.05.2020, “*Për fillimin e marrëdhënieve financiare*”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, nëpunësi Sokol Kananaj, është konfirmuar si “*nëpunës civil*”, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave*”, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, kategoria e pagës III-b, dhe me aktin nr. 13106/1 prot., datë 12.08.2025, “*Vërtetim*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Vlorë, provohet se, kandidati Sokol Kananaj ka qenë “*nëpunës civil*” i konfirmuar, në pozicionin “*Drejtor, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore*”, klasa e pagës II-2, pranë Bashkisë Vlorë, ç’ka e vërteton faktin se nëpunësi gëzon statusin e nëpunësit civil;
- në lidhje me plotësimin e kushtit që të mos ketë masë disiplinore në fuqi: ky fakt vërtetohet nga përmbajtja e aktit nr. 13106/1 prot., datë 12.08.2025, “*Vërtetim*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Vlorë;
- sa i takon nivelin të vlerësimit të fundit: nga formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar - Qershor 2025, për nëpunësin në fjalë, niveli i vlerësimit ka qenë 1 “*Shumë mirë*”;

- *sa i përket plotësimi të kriterëve të posaçme*: rezulton se, kandidati zotëron diplomë të lëshuar në vitin 2008, nga Universiteti “*Ismail Qemali*”, Vlorë, Fakulteti i Ekonomisë dhe Drejtësisë, dega Turizëm; Diplomë Master Profesional në “*Sipërmarrje në Turizëm*”, dhënë nga Universiteti “*Ismail Qemali*”, Vlorë, Fakulteti i Ekonomisë; si dhe Diplomë “*Bachelor*”, në Financë, dhënë nga Akademia e Studimeve të Aplikuara “*REALD*”, Vlorë, Fakulteti i Ekonomisë.
- *në lidhje me përvojën në punë*: referuar librezës së punës dhe Vërtetimit për Bazën e Vlerësuar, të lëshuar në datën 01.02.2026, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, rezulton se, kandidati ka përvojën e kërkuar për punën në profesion, duke plotësuar kërkesën e vjetërsisë në punë të publikuar në shpallje.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin se kandidati i kualifikuar në fazën e lëvizjes paralele Sokol Kananaj, në procedurën e konkurrimit me kod #7481, të shpallur nga DAP, rezulton të jetë nën hetim penal, për veprën penale “*Shpërdorim detyre*”, vepër e regjistruar pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë: sipas aktit: “*Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore*”, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sipas kërkesës nr. 19, datë 29.01.2026, të regjistruar në sistem provohet se, shtetasi Sokol Kananaj, është i pa dënuar;

Nga ana tjetër, sa i takon momentit të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, me institucionin e bashkisë Vlorë, rezulton se, me aktin nr. 89 (11510/1 prot.), datë 14.07.2025, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të punonjësve të Bashkisë Vlorë*”, të Kryetarit të Bashkisë është miratuar dorëheqja e nëpunësit sipas kërkesës së tij. Në këto kushte, në mbështetje të pikës 4, të nenit 64, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë që të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, kandidati Sokol Kananaj, i përmbush kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për tu kualifikuar si kandidat në fazën e lëvizjes paralele për plotësimin e pozicionit të shpallur me kod #7481, nga DAP-i.

Në vijim, të procesit të rekrutimit, rezulton se DAP-i, në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe të kreut II, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, pas përfundimit të procedurës së konkurrimit, në fazën e lëvizjes paralele, ka njoftuar se fitues është shpallur kandidati Sokol Kananaj, si dhe ka njoftuar se procedura e ngritjes në detyrë për pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë*”, mbyllet për shkak të plotësimi të pozicionit të punës.

Në përfundim të analizës së fakteve të parashtruara më sipër, arrihet në konkluzionin se, procedura e konkurrimit me kod #7481, “Shpallje për lëvizje paralele, ngritje në detyrë, në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”, për pozicionin: “Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë - klasa e pagës III-1”, të shpallur nga DAP-i, është zhvilluar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të nenit 90, pika 2, e ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 16, pika 6, e Rregullores “Për procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, të filluar në bazë të informacionit të administruar pranë Komisionerit nr. 362 prot., datë 23.02.2026, duke qenë se, nuk konstatohen shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil gjatë realizimit të procedurës së konkurrimit me kod #7481, të shpallur nga DAP, në kushtet kur veprimet e njësisë përgjegjëse për verifikimin e kandidatëve, vlerësohet se janë kryer në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Departamentit të Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)